

## Vërtetime të ndryshme

Për të aplikuar për vërtetime të ndryshme klikoni në lidhjen si më poshtë:

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/Packages.aspx?lvl=3&path\\_code=29-1083&cat\\_id=29](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/Packages.aspx?lvl=3&path_code=29-1083&cat_id=29)

Pranë Ambasadës Shqiptare në Athinë mund të tërhiqni:

### Vërtetim të aktit martesor

Vërtetim të aktit martesor, merret për martesat e lidhura në Ambasadën e RSH-së në Athinë ose në Zyrën e Gjendjes Civile në Shqipëri.

Dokumentacioni:

- Pasaporta
- Certifikata e martesës së bërë në Ambasadë ose në Zyrën e Gjendjes Civile në Shqipëri

### Vërtetim për saktësim të dhënash personale

Vërtetim për saktësim të dhënash personale ne rastet kur ka ndryshime ne emër, mbiemër, datëlindje ose vendlindje

Dokumentacioni

- Pasaportat para dhe pas ndryshimit si dhe vërtetimi nga Zyra e Gejndjes civile në Shqipëri që vërteton ndryshimin e të dhënave

### Vërtetim për ndryshim pasaporte

Vërtetim për ndryshim pasaporte në rast martese, ndarje, humbje ose rinovimi

Dokumentacioni sipas rastit përkatës:

- Pasaportat dhe certifikata e martesës
- Pasaportat dhe vendimi i ndarjes
- Pasaporta dhe vërtetimi i humbjes
- Pasaporta e skaduar dhe Pasaporta e re

### Vërtetime shkollore

Vërtetime shkollore për njohjen e diplomave shqiptare

Dokumentacioni

- Vërtetimi i shkollës i legalizuar nga Ministria e Arsimit dhe i pajisur me vulë Apostile nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

### Vërtetime të njësisë më origjinalin

Dokumentacioni

Pasaporta

### Tarifa e shërbimit

Tarifa konsullore për të gjithë llojet e vërtetimeve është 30 euro. Pagesa mund të kryhet me çdo lloj kartë bankare nëpërmjet aparaturave POS të instaluar në Zyrën tonë Konsullore ose me kartëmonedha (CASH) në bankomatit pranë Ambasadës, të përshtatur në gjuhën shqipe.